



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

# RREGULLORE E DIPLOMIMIT



## NENI 1 Objekti dhe Qëllimi

Rregullorja e Diplomimit vendos rregullat normative të marrëdhënieve që krijohen midis subjekteve të përfshira në procesin e diplomimit, të cilat përcaktojnë të drejtat e detyrimet e diplomantëve, rregullat për organizimin e procesit si dhe raportet e tyre me organet drejtuese dhe strukturat e tjera të njëjësive kryesore. Rregullorja ka për qëllim të sigurojë kuadrin e brendshëm juridik të nevojshëm për mbarëvajtjen e procesit të diplomimit, të sigurojë rregulla të njëjta për disiplinën studentore dhe administrative, si dhe të garantojë standarde të cilësisë në hartimin e tezës së diplomës.

## NENI 2 Baza Ligjore

Rregullorja e diplomimit në Programin e Studimeve të Ciklit të Dytë Master i Shkencave bazohet në:

- Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- Standardet për akreditimin e Programeve të Studimeve të Ciklit të Dytë “Master i Shkencave”.
- Statutin e UST-së, Rregulloren e Brendshme dhe Rregulloret e njëjësive kryesore dhe të Programit të Ciklit të Parë dhe të Dytë të studimeve.
- Sipas nenit 75, pika 5 e Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” në Institucionet e Arsimit të lartë, studimet e Ciklit të Dytë “Master i Shkencave” përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master i Shkencave” në fushën e arsimimit të kryer.

## NENI 3 Diplomimi në programet e ciklit të parë “Bachelor” dhe ciklit të dytë “Master Profesional”

1. Studentët e Ciklit të Parë të studimeve “Bachelor” dhe studentet e Ciklit të Dytë “Master Profesional” sipas përcaktimit në kuadrin rregullativ të UST-së diplomohen me provim.
2. Për çdo program studimi janë përzgjedhur lëndët bazë formuese, nga të cilat hartohet banka e pyetjeve. Studentët njihen me bankën e pyetje në fillim të semestrit të fundit.
3. Teza hartohet nga komisioni prej së paku tre anëtarësh.
4. Teza ka 100 pikë të ndara në mënyrë të barabartë për secilën nga lëndët e përzgjedhura për provimin e diplomës në programin përkatës.

## NENI 4 Parakushte të marrjes së temës së Diplomës

### Modalitetet e diplomimit

- a) Në përfundim të kursit të plotë të studimeve universitare, studenti ka të drejtë të diplomohet. Studenti i regjistruar në programin “Master i Shkencave” ka të drejtë të paraqitet në provimin e formimit apo në mbrojtjen e tezës së diplomës **vetëm pasi ka shlyer të gjitha detyrimet akademik - administrative me UST-në.**



- b) Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 76 dhe në aktet nënligjore, për programin e integruar të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" kriteri diplomimi është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frengjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj është i përcaktuar me akt nënligjor të ministrisë përgjegjëse të arsimit të lartë.
- c) Studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa shlyer më parë të gjitha detyrimet dhe pa fituar numrin e krediteve të parashikuara në planet mësimore të programit të studimit.
- d) Studenti, para mbrojtjes së punimit të diplomës duhet të ketë likuiduar të gjitha detyrimet financiare dhe materiale që mund të ketë me universitetin, bibliotekën shkencore.
- e) Diplomimi i studentëve kryhet në sezonet e parashikuara në kalendarin akademik. Përpara çdo sezoni provimi për diplomim studentët kanë të drejtën e likuidimit të detyrimeve të prapambetura (kolokiume, seminare, ushtrime, detyra, projekte, praktike mesimore apo provime të mbartura).

### **NENI 5 Objektivat**

Rregullorja ka si objektiv:

1. Kualifikimin dhe edukimin e studentëve të pavarur në nivel të lartë në përputhje me parimet e njohura shkencore dhe etike.
2. Kryerjen nga studentët e njësive kryesore të projektit kërkimor.

### **NENI 6 Fusha e veprimit**

Fusha e veprimit të rregullores është veprimtaria formuese që lidhet me përgatitjen e tezës së diplomës, në programet e studimeve të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" në të gjitha departamentet e UST-së nga aplikimi deri në përfundim.



### **NENI 7 Teza e diplomës**

Teza e diplomës është një punë e pavarur dhe krijuese e studentit në formën e një projekti apo studimi me karakter përgjithësues në disiplinat e lidhura drejtpërdrejtë me formimin e marrë gjatë zhvillimit të programit të studimit. Teza e diplomës përmban një sërë detyrash e kërkesash, mënyra e shtrimit e të cilave i jep mundësi studentit, që nëpërmjet njohurive të fituara gjatë periudhës së shkollimit dhe punës konkrete studimore, të tregojë aftësitë e tij profesionale dhe kompetencën për të kryer studime konkrete ose empirike. Teza e diplomës është individuale. Tezat e diplomës përcaktohen nga departamenti përkatës dhe miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit. Të përcaktimin e tezave të diplomës, departamentet dhe fakulteti mund të bashkëpunojnë edhe me institucione publike apo private që punojnë në fushat përkatëse. Diplomantët paraqesin për miratim kërkesat me temat e propozuara si dhe udhëheqësin në Departamentin përkatës. Formulari i propozimit të temës duhet të jetë i firmosur nga diplomanti dhe udhëheqësi. Studenti ka të drejtë të shprehë dëshirën e tij në lidhje me tezën e diplomës që kërkon të zhvillojë, si dhe udhëheqësin e tij. Ai mund të propozojë edhe vetë një tezë tjetër diplome së bashku me udhëheqësin përkatës. Departamenti shqyrton të gjitha kërkesat specifike të studentëve, duke i harmonizuar ato me kushtet aktuale, pa cenuar nivelin e cilësinë e punimeve të diplomave.

## **NENI 8**

### **Udhëheqja e diplomës**

- Udhëheqja e temës së diplomës kryhet nga departamentet përkatëse.
- Udhëheqësi është përgjegjës për ecurinë dhe mbarëvajtjen e temës dhe procesit të diplomimit. Diplomanti zgjedh një Udhëheqës në Departament, i cili miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit. Kriteret që duhet të përmbushë Udhëheqësi i diplomës vendosen nga departamenti përkatës.
- Udhëheqësi i temës së diplomës së bashku me diplomantin përgatit programin e punës, duke vendosur edhe afatet përkatëse. Studenti duhet të respektojë afatet e vendosura për të bërë të mundur mbrojtjen me sukses të temës në sesionin normal të mbrojtjes së diplomës.
- Udhëheqësi përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilit konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar. Grafiku i konsultimeve është i detyrueshëm të zbatohet nga studentit.
- Para mbrojtjes së tezës së diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studentit. Ai jep mendimin e tij për nivelin cilësor, elementët e punës krijuese të studentit dhe lejimi i mbrojtjes së punimit.

## **NENI 9**

### **Udhëheqësi i Diplomës**

Studenti paraqet ecurinë e punës së tij tek udhëheqësi i temës. Udhëheqësi duhet të:

- Miratojë temën e diplomës
- Miratojë programin e punës të diplomantit
- Asistojë udhëheqjen e diplomës
- Rekomandojë literaturën për thellimin teorit
- Mbikëqyrë çdo javë ecurinë e diplomës
- Rekomandojë ndryshime nëse gjykohet e nevojshme
- Ofrojë konsulencë të specializuar në fusha specifike
- Organizojë kontrollat e diplomës
- Studenti fiton të drejtën për të mbrojtur diplomën, kur ai ka përfunduar të gjithë programin e punës të përcaktuar nga udhëheqësi.



## **NENI 10**

### **Mbrojtja dhe vlerësimi**

- Të gjitha tezat e diplomave, para se të lejohen për mbrojtje, miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit.
- Punimi i diplomës mbrohet para një komisioni të posaçëm, të përbërë nga staf akademik i departamentit.
- Mbrojtja e diplomës është publike. Komisioni i mbrojtjes së diplomave përbehet nga 3 anëtarë.
- Komisioni funksionon kur janë prezent jo më pak se 2/3 e anëtarëve të tij.
- Secili nga anëtarët ka në dispozicion një vlerësim nga 4-10.
- Rezultati përfundimtar i diplomës përlllogaritet në bazë të mesatares aritmetike të vlerësimit të të gjithë anëtarëve.
- Vlerësimi me notë bëhet nga 10 (dhjetë) deri në 4 (katër). Nota regjistrohet në procesverbalin e mbrojtjes së diplomave.
- Procesverbali firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit.

- Në përfundim të çdo seance mbrojtjeje, në mënyrë publike kryetari i komisionit, në prani të anëtarëve, i komunikon çdo diplomanti notën, me të cilën është vlerësuar punimi i tij.
- Në rast se studenti vlerësohet me notë jo kaluese në mbrojtjen që i bën tezës së tij, ai mund të mbrojë përsëri të njëjtën tezë ose të mbrojë një tezë të re jo më shpejt se sezonin pasardhës i diplomimit.

## **NENI 11**

### **Dispozita e fundit**

Me miratimin e Rregullores së Diplomimit në njësinë kryesore ajo bëhet pjesë e rregullores së programit të studimit.



## UDHËZUES PËR MËNYRËN E REALIZIMIT TË TEZËS SË DIPLOMËS NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË

### TEZA E DIPLOMËS

1. Për diplomën “Master i Shkencave”, studenti realizon një tezë diplome në një nga fushat kryesore të studimit të cilën e përmbyll me paraqitjen e tezës në formën e një prezantimi. Teza shkruhet në gjuhën shqipe ose angleze.
2. Teza e diplomës është një detyrë profesionale e përgatitur me standarde shkencore, që trajton një temë të lidhur ngushtë me praktikën dhe formimin teorik. Tema e diplomës duhet të marrë në konsideratë diskutimet përkatëse, thelbësore mbi rezultatet e studimeve të siguruara në vendin tonë dhe ato ndërkombëtare. Teza e diplomës duhet të realizohet duke marrë parasysh dhe aplikuar literaturën vendase dhe ndërkombëtare, nën drejtimin e udhëheqësit. Teza e diplomës është një mundësi për të demonstruar rezultatet e mësimin dhe kreativitetin e studentit.
3. Teza e diplomës është momenti në të cilën studenti demonstroi përvetësimin e objektivave formues e të kompetencave profesionale e shkencore të programit. Kjo është një mundësi për të dëshmuar pjekurinë e tij/saj akademike dhe aftësinë për të vendosur mendimet e tyre në një material të shkruar me karakter shkencor. Studenti duhet të tregojë se është në gjendje të zgjedhë një temë të përshtatshme, të përcaktojë një hipotezë shkencore dhe të zotërojë metodat e kërkuara kërkimore. Përveç kësaj, studenti duhet të demonstrojë që ka qasje kritike dhe logjike dhe respekton e praktikën dhe rregullat akademike në kërkimin shkencor.
4. Përmbajtja e tezës së diplomës paraqet reflektim të pavarur mbi fenomenet, njohuri mbi diskutimet teorike për fushën e kërkimit, aplikimin e metodave kërkimore dhe integrimin e të dhënave teorike dhe empirike. Për më tepër, shkrimi i tezës së diplomës i mundëson studentit të mësojë gjëra të reja për veten e tij/saj, për shembull, për kapacitetin, perceptimin, kreativitetin, këmbënguljen dhe mënyrën e të punuarit.
5. Realizimi i tezës së diplomës zakonisht zgjat një semestër. Mund të bëhet edhe më shpejt, por procesi i shkrimit shpesh herë merr kohën e vet. Procesi i realizimit të tezës kërkon realizimin e një pune afatgjatë të pavarur dhe përbëhet nga faza të ndryshme. Kjo është arsyeja pse studentit duhet të përcaktojë një plan pune dhe të vendosi disa objektiva për veten e tij/saj që në fillim të procesit. Gjatësia e punimit të tezës së diplomës ndryshon në varësi nga fusha e studimit dhe të dhënat e kërkimit. Përgjithësisht ajo duhet të jetë 60-80 faqe A4.

### ORIENTIMI DHE SPECIFIKIMI I TEMËS SË DIPLOMËS.

1. Planifikimi i tezës së studentit fillon duke lexuar literaturën kërkimore më bashkëkohore mbi temën. Studenti harton çfarë është e njohur për temën dhe si është studiuar. Pyetjet dhe hipotezat që kanë lidhje me temën e studimit qartësohen gjatë këtij procesi. Studentët mund të gjejnë individualisht punime shkencore të mëparshme në lidhje me temën në mënyra të ndryshme, ku përfshihen kërkime në bibliotekën universitare dhe database elektronike, revista shkencore, seritë e botimeve shkencore (periodikët) si dhe në bazë të këshillave të dhëna ose të siguruara nga udhëheqësi/mbikqyrësi i temës.



2. Studenti këshillohet që ta konsideroj shumë të dobishëm konsultimin dhe përdorimin e botimeve shkencore në formën e revieë, monografive dhe bibliografisë së përdorur në tekste apo traktate. Studentët gjatë leximit të literaturës duhet ti kushtojnë vëmendje referencave të lidhura me temën, si dhe ato që lidhen me teorinë, metodat dhe analizat. Leximi i literaturës e ndihmon studentin që të zbuloj atë që dihet për temën deri tani dhe në të njëjtën kohë për të gjetur ide të reja - teori të reja, hipoteza - që mund të aplikohen në punën e tyre kërkimore shkencore.

3. Orientimi në kërkimet e mëparshme dhe krijimi i një sfondi teorik duhet të sinkronizohet me detyrën kërkimore të studentit. Përcaktimi siç duhet i detyrës kërkimore është shumë i rëndësishëm në mënyrë që studentit të njoh gjithnjë atë që po bën. Studenti duhet të jetë në gjendje të përmbledhë në një pyetje të vetme kryesore problemin e kërkimit që do të realizoj. Studenti nuk duhet të harroj se mund të vazhdoj studimin e temës edhe në realizimin e tezës së tij si pjesë e studimeve më të thelluara pasuniversitare si përshembull doktoraturë.

## UDHËHEQJA E TEZËS


1. Studenti ka të drejtë të përfitoj udhëheqje aktive dhe me cilësi të lartë gjatë procesit të tezës. Studenti nuk duhet të harroj të kontaktoj udhëheqësin e tij/saj në mënyrë aktive – realizimi i tezës së diplomës nuk është vetëm përgjegjësia e udhëheqësit. Studenti duhet të shfrytëzoj ekspertizën dhe përvojën e udhëheqësit në kërkime duke i bërë pyetje dhe në këtë mënyrë studentit teston apo vlerëson interpretimet e veta në lidhje me punimin shkencor. Studenti nuk duhet të hezitoj të pyesë drejtpërdrejt nëse diçka duket e paqartë. Në të njëjtën mënyrë, studentit duhet të sigurohet që udhëheqësi të kuptojë atë që ai/ajo e konsideron veçanërisht interesante në fushën e temës, në mënyrë që udhëheqësi/a të mund ta udhëzojë pikërisht në drejtimin e duhur.

2. Studenti gjithmonë duhet të përgatitet me kujdes për takimet me udhëheqësin. Studenti duhet të mendoj paraprakisht se cilat pyetje duhet të sqarohen në atë moment të veçantë. Nëse paraprakisht studentit i ka dhënë një tekst udhëheqësit, rekomandohet që duhet të shënohen dhe të komentohen problemet aktuale që konsideron ai/ajo në tekst ose t'i listoj ato veçmas. Studenti nuk duhet të hezitoj të paraqesë edhe seksione të papërfunduara, sepse e ndihmojnë udhëheqësin që të komentojë mbi punën e tij/saj dhe të kuptojë pikat që mund të jenë problematike për të. Megjithatë, studentit duhet të kuptoj se ai/ajo është në mënyrë të pavarur përgjegjës për vendimet që kanë të bëjnë me përmbajtjen dhe formën e tezës së tij/saj.

3. Departamenti kërkon vlerësim paraprak zyrtar për tezat e diplomës të paktë 2 të tillë gjatë semestrit që përgatitet teza. Përpara se të dorëzohen tezat e diplomës për vlerësim përfundimtar, studentit duhet të kontaktoj udhëheqësin në mënyrë që të siguroj miratimin e tij/saj në lidhje me tezën.

4. Është e detyrueshme që studentit të konsultohet me udhëheqësin të paktën katër herë gjatë përgatitjes së tezës së diplomës (herën e parë kur studentit merr temën, herën e dytë dhe të tretë kur studentit raporton për punën e kryer deri në atë moment në departament dhe herën e katërt kur udhëheqësi vlerëson rezultatet finale të studentit dhe jep udhëzime se si të finalizohet puna, shkrimi dhe dorëzimi i tezës së diplomës).

5. Është detyrë e udhëheqësit të jetë në dispozicion për t'u konsultuar nga studentit. Në sesionet e këshillimit udhëheqësi ndihmon studentin në mbledhjen e literaturës dhe burimeve të nevojshme për realizimin e tezës së diplomës, vlerëson nëse puna është në përputhje me planin dhe jep rekomandime në lidhje me çështjet që mund të lindin gjatë punës. Është gjithashtu detyra e



udhëheqësit për të ndihmuar studentin në arritjen e formës përfundimtare të tezës së diplomës, duke pasur parasysh kërkesat formale dhe përmbajtjen e saj.

6. Drejtuesi i departamentit mund të refuzojë vazhdimin e shkrimit të tezës së diplomës dhe realizimin e mbrojtjes së tezës së diplomës, nëse udhëheqësi tregon se studenti nuk i përmbush detyrimet e tij në mënyrë të vazhdueshme. Nëse udhëheqësi, në përputhje me opinionin e studentit, nuk jep ndihmë të vlefshme në shkrimin e tezës së diplomës, studenti mund të kontaktojë drejtuesin i departamentit për të siguruar një ndihmë të përshtatshme.

7. Teza e diplomës përfundimtare duhet të dorëzohet në departament në dy kopje identike, të printuara, dhe në mënyrë elektronike, në CD (si në Word dhe format PDF).

8. Nëse studenti nuk e dorëzon tezën e diplomës në afatin e caktuar por për arsye që nuk kanë të bëjnë me të, afati mund të zgjatet në një maksimum prej një jave, me kontributin me shkrim të udhëheqësit dhe drejtuesit të departamentit (në rast se mendimet e tyre ndryshojnë, vendimi i udhëheqësit të departamentit).

## SHKRIMI I TEZËS



1. Shkrimi është natyrisht një pjesë thelbësore e procesit të tezës së diplomës. Studenti në vazhdimësi gjatë procesit të shkrimit, për shembull, për çështjet që lidhen me temën; krijon një fletore pune shkencore, përcakton strukturën e tezës dhe tabelën e përmbajtjes dhe bën shënime mbi literaturën që ka lexuar. Studenti kur lexon literaturën, nuk duhet të harroj të shkruaj të dhënat e plota bibliografike, si dhe mendimet që janë shkruar në tekste. Studenti duhet të shkruaj gjithmonë sa herë që ka një ide të tij/saj në lidhje me temën. Studenti nuk duhet të shkruaj thjesht citate por, mbi të gjitha, se sa teksti që lexon është i lidhur me tezën e tij/saj. Këto lloj shënimesh dhe skicimi ofrojnë një bazë solide për tekstin përfundimtar të temës së diplomës.

2. Si përmbajtja ashtu edhe forma janë të rëndësishme në një raport vlerësues shkencor. Shkrimi i një tezë, është një mundësi për të treguar se studenti ka zhvilluar një mënyrë akademike të të menduarit dhe aftësinë për të prodhuar tekst logjik me stil të mirë akademik. Rezultatet duhet të interpretohen dhe jo vetëm të raportohen.

3. Shkrimi i tezës nganjëherë mund të jetë i vështirë - sidomos nëse është detyra e parë e shkruar në shkallë të gjerë për studentin. Megjithatë shkrimi duhet të praktikohet edhe pse duket i vështirë. Studenti është më mirë që të shkruaj shumë më tepër sesa shumë më pak: teksti gjithmonë më pas mund të shkurtrohet dhe të redaktohet. Studenti nuk duhet të mendoj se po prodhon tekst në formën e tij përfundimtare. Kryesore është që studenti të arrijë të vendosi mendimet e tij/saj në letër. Idetë, struktura dhe formatimi mund të redaktohen më pas. Etika dhe kryerja e përgjegjshme e kërkimit duhet të mbulojnë tërë procesin nga përzgjedhja e temës deri në raportimin e rezultateve.

## LLOJI DHE PLANI I KËRKIMIT

- **Propozimi i Kërkimit:** Ekziston një mënyrë mbi standardet bazë shkencore që zbatohen për një studim shkencor. Mbi të gjitha, standardet shkencore që zbatohen janë si në vijim:

- Teza duhet të jetë e bazuar në teori
- Kërkimi duhet të jetë i verifikueshëm



- Kërkimi duhet të jetë në parim i riprodhueshëm
- Për të siguruar që kërkimi juaj është në përputhje me këto rregulla, studenti duhet të filloj të realizoj një propozim kërkimor duke ndjekur këto standarde. Një propozim përbëhet nga pjesët e mëposhtme:
- **Deklarimi i problemit:** Kjo jep motivimin për përzgjedhjen e temës dhe një përshkrim të qartë të fushës së problemit. Kjo pjesë përfshin një rishikim të literaturës teorike dhe empirike, e cila është më e rëndësishme për temën dhe siguron që tema ende nuk konsiderohet e shteruar nga studiues të tjerë.
  - **Korniza teorike:** Kjo pjesë jep sfondin e temës së studentit dhe ka për qëllim të formuloj pyetjet/hipotezat kërkimore. Cili informacion është i njohur tashmë nga literatura? Teoria vepron si bazë për kërkime të mëtejshme dhe si krahasim për rezultatet e ardhshme. Studenti duhet të tregoj cilat koncepte janë të rëndësishme për t'u shqyrtuar në përgjigjet e pyetjeve të kërkimit.
  - **Qëllimet dhe pyetjet/hipotezat e kërkimit:** Kjo tregon qartë objektivat shkencore të kërkimit. Objektivat e kërkimit, është e rëndësishme që të jenë të lidhura ngushtë me temën e kërkimit. Më pas, objektivi i kërkimit duhet të përkthehet në pyetje/hipoteza kërkimore. Këto janë pyetjet që duhet të testohen dhe/ose të gjejnë përgjigje në mënyrë që të përmbushen objektivat e kërkimit.
  - **Metodologjia:** Në këtë pjesë të propozimit duhet të sqarohet se si pyetjet teorike të kërkimit mund të shqyrtohen dhe të gjejnë përgjigje në mënyrë empirike. Funkcioni i pjesës së metodologjisë brenda propozimit të kërkimit (dhe më vonë në raportin e tezës) është të përcaktojë besueshmërinë, vlefshmërinë dhe përsëritjen e kërkimit. Studenti duhet të ketë parasysh se është e rëndësishme të mendoj për analizimin e të dhënave përpara se të fillojë të grumbulloj të dhënat.
  - **Plani i punës dhe afati kohor:** Propozimi kërkimor në fund duhet të plotësohet me një plan pune gjithëpërfshirës, duke treguar hapat e nevojshëm në kryerjen e kërkimit, rendin e tyre logjik në kohë, specifikimin e detyrave dhe progresin e arritur - të gjitha për të siguruar që ngarkesa e punës është realiste dhe puna e tezës së diplomës po përparon në mënyrën e duhur. Studentët duhet të bëjnë një plan kërkimi ose pune.

## PËRGATITJA E PREZANTIMIT TË TEZËS



1. Periudha e kohës për prezantimin e punimit përfundimtar është 20-35 minuta. Prezantimi realizohet me gojë në formatin Poëer Point. Prezantimi duhet të pasqyroj të gjitha pjesët e tezës së diplomës, rezultatet thelbësore të siguruar nga studenti, diskutimin e tyre, skemat, tabelat. 25-40 slides janë të rekomanduara për paraqitjen e prezantimit.
2. Slides duhet të përgatiten në mënyrë cilësore: nuk rekomandohet më shumë se 8 deri në 10 rreshta teksti për slide, të përgatiten në mënyrë të tillë që të mund të jenë plotësisht të lexueshme, sfondi dhe ngjyrat e shkronjave duhet të ketë kontrast të mjaftueshëm.
3. Për të shmangur vështirësitë e papritura gjatë mbrojtjes së tezës, rekomandohet që paraprakisht studenti të përgatisë prezantimin dhe ta lexoj me zë të lartë përpara udhëheqësit ose kolegëve të tij/saj. Nëse ekziston mundësia për të regjistruar një provë të prezantimit, rekomandohet që studentët ta bëjnë këtë, sepse është shumë e dobishme ta vlerësoj veten më vonë dhe ta konsideroj atë në mënyrë kritike në mënyrë që të realizoj përmirësime.
4. Gjatë prezantimit leximi i tepërt duhet të shmanget. Komisioni shkencor ka më shumë gjasa të bindet kur një student flet qartë dhe lirshëm në lidhje me prezantimin e tij/saj duke theksuar pikat kyçe të punimit. Ndërsa i përgjigjet pyetjeve të komisionit shkencor dhe vërejtjeve të recensuesit, studenti mund të përdorë punën e tij/saj dhe ta citojë atë. Përgjigjet duhet të jenë specifike dhe të shkurtra.

5. Në fund të mbrojtjes, studenti mund t'i përgjigjet vërejtjeve apo pyetjeve të komisionit shkencor nëse ka. Studenti mund të tregojë më shumë rreth planeve të tij të mëtejshme të kërkimit dhe të falënderojë të gjithë ata që ndihmuan për përgatitjen e tezës.

## STRUKTURA E PREZANTIMIT TË TEZËS SË DIPLOMËS

1. Tema e diplomës
2. Faqja e titullit (universiteti, fakulteti, titulli i tezës, emri i autorit, mbiemri, grupi mësimor-kërkimor, e- mail, emri dhe mbiemri i udhëheqësit shkencor)
3. Problemi shkencor dhe rëndësia e tij
4. Objekti, qëllimi dhe objektivat e tezës, metodat e kërkimit
5. Baza shkencore e tezës së diplomës (teoritë, standardet, materiali dhe metodat e përdorura)
6. Rezultatet e pjesëve teorike-analitike të tezës
7. Thelbi i zgjidhjes së propozuar, karakteristikat kryesore, dallimet dhe ngjashmëritë në krahasim me zgjidhjet ekzistuese
8. Rezultatet e kërkimit eksperimental
9. Konkluzione dhe rekomandime
10. Përshkrimi i një artikulli të shkruar dhe të botuar nga studenti (nëse ka).

## PROCEDURA E MBROJTJES SË TEZËS SË DIPLOMËS

Mbrojtja e tezës së diplomës është publike, dmth. të gjithë ata që dëshirojnë të marrin pjesë në mbrojtje (të jenë në sallën ku zhvillohet mbrojtja, të propozojnë pyetje për të diplomuarit, të marrin pjesë në diskutime dhe të vlerësojnë punën). Mbrojtja zhvillohet në rendin e mëposhtëm:

1. Kryetari i komisionit shkencor hap procedurën e mbrojtjes duke paraqitur përpara sallës autorin e punimit, temën, emrin e udhëheqësit akademik dhe fton autorin të flasë.
2. Studenti paraqet punën e tij/saj në 20-35 min.
3. Kryetari ose një anëtar i komisionit shkencor paraqet vlerësimin e recezentit.
4. Studenti përgjigjet ndaj vërejtjeve dhe pyetjeve (nëse ka).
5. Ai/ajo duhet t'i përgjigjet pa ndonjë përgatitje shtesë.
6. Anëtarë të tjerë të komisionit ose pjesëmarrës në mbrojtje mund të japin vërejtjet e tyre; komente të tjera mund të bëhen (nëse ka).
7. Kryetari i komisionit shkencor mbyll procedurën e mbrojtjes. Pasi komisioni shkencor ka dëgjuar të gjitha prezantimet, mbahen seanca të mbyllura ku komisioni shkencor vlerëson punimet sipas kriterëve të vlerësimit. Pas seancës, kryetari i komisionit shkencor paraqet vlerësimin përfundimtar të punimeve që vendoset në Diplomë dhe Supplementin e Diplomës.

## KRITERET E VLERËSIMIT TË TEZËS SË DIPLOMAVE

**Nuk do të lejohet të mbrohet asnjë tezë diplome që përmban plagjiaturë!**

Çdo citim apo shprehje në material pa vendosur thonjëza dhe treguar burimin, figura, tabela, të dhëna statistikore ose ilustrime pa referencë ndaj burimit, perifrazimi i një teksti të plotë ose pjesë të tij (p.sh. e riformuluar nga autori me fjalët e tij) pa iu referuar burimit, konsiderohen plagjiaturë.



- ✓ Struktura e tezës së diplomës
  - A është transparente?
  - A korrespondon përmbajtja e tij me titullin?
  - A ka ndonjë rekomandim të ardhshëm, konkluzione?
  - A është struktura e punimit profesionalisht korrekte dhe logjike?
  - A janë pjesët dhe nënpjesët e veçanta të ndara në mënyrë të përshtatshme nga njëri-tjetri?
  
- ✓ Rëndësia profesionale e tezës së diplomës
  - A e arrin objektivin, a janë përfundimet e mbështetura?
  - A paraqiten temat përkatëse të përmbajtjes në tezën e diplomës?
  - A ka zbatuar autori saktësisht metodat dhe mjetet që shfaqen në pjesën studimore dhe eksperimentale dhe në analizën e diskutimit qendror të tezës së diplomës?
  - A tregohen të gjitha metodat e nevojshme analitike?
  - A janë rezultatet dhe konkluzionet logjike dhe të vlefshme,
  - A vlerësohen ato duke marrë në konsideratë të dhënat e literaturës përkatëse?
  
- ✓ Përdorimi i referencave
  - A përdor studentët referencat në mënyrë korrekte?
  - A i përmbledh studenti në mënyrë korrekte dhe me arsyetim kritik në pjesën, Hyrje apo të Dhënat e Literaturës dhe Interpretim i Rezultateve?
  - A janë citimet në përputhje me kërkesat?
  - A paraqiten citimet e përfshira në tekst në listën e referencave (dhe anasjelltas)?
  - A është lista e referencave e përshtatshme (a ka literatura të përshtatshme, a është e përditësuar, a është e përshtatshme për temën)?
  - A përputhet me kërkesat formale?
  - A përfshihen në referenca literaturë kombëtare dhe ndërkombëtare?
  
- ✓ Përdorimi i figurave dhe tabelave, kërkesa të tjera formale
  - A janë të gjitha figurat dhe tabelat të përmendura në tekst?
  - A janë figurat dhe tabelat të përcaktuar me numra, a kanë tituj dhe referenca ndaj burimit?
  - A ka një tabelë të përmbajtjes?
  - A janë vendosur numra tek faqet?
  - A është drejtshkrimi dhe formulimi i saktë?
  
- ✓ Përdorimi korrekt i termave teknikë
  - A është terminologjia e përdorur nga autori uniforme dhe korrekte?
  - A përdor studentitë terma të huaj në mënyrë të njëtrajtshme (përdorimi koherent i terminologjisë mjekësore në gjuhën latine, emrat e institucioneve)?
  - A përdor studentitë një listë shkurtimesh, përkufizimesh?
  - A jep një tablo uniforme teza e diplomës?



## KËRKESAT

1. Kërkesat në lidhje me përmbajtjen e tezës së diplomës  
Teza e diplomës është një studim konsultativ i bazuar në punën individuale profesionale, duke konfirmuar njohuri të qarta. Teza e diplomës duhet të respektoj rregullat dhe drejtshkrimin e

gjuhës shqipe. Struktura e kapitujve individualë dhe marrëdhëniet e tyre me njëra-tjetrën duhet të jenë logjike, pasuese, mënyra e të shkruarit e vazhdueshme, përshkrues, tekst i lirë.

## PËRMBAJTJA DHE FORMA E TEZËS

Teza duhet të përfshijë këto pjesë:

### 1. Paraqitja e tezës:

- a. Faqja e titullit
- b. Falenderimi (opsional)
- c. Tabela e Përmbajtjes
- d. Lista e tabelave dhe figurave
- e. Lista e shkurtesave dhe simboleve
- f. Fjalori (opsional)

Teksti kryesor i tezës përmban:

#### a. Hyrja

Studenti ofron karakteristika të shkurtra dhe të përshtatshme të njohurive ose praktikës aktuale në terren, që kanë të bëjnë me temën e tezës dhe informon lexuesin për rëndësinë, qëllimet dhe objektivat e tezës. Autori shpjegon pse ai/ajo e konsiderojnë punën e rëndësishme dhe pse është përzgjedhur tema e paraqitur.

#### b. Pjesa qëndrore

Gjendja aktuale e çështjes së studiuar në vendin tonë dhe jashtë vendit. Në këtë pjesë autori paraqet informacion dhe njohuritë në dispozicion për temën e dhënë. Burimi gjendet në punimet e publikuara kohët e fundit nga autorë vendas dhe të huaj. Kjo pjesë duhet të përbëjë përafërsisht 30% të tezës.

#### ➤ Qëllimi i punës

Qëllimi i punës duhet të shprehet në mënyrë të qartë, koncize dhe me saktësi. Kjo pjesë duhet gjithashtu të përfshijë qëllime të pjesshme në proces, të cilat janë të pashmangshme për arritjen e qëllimit kryesor.

#### • Metodat e punës dhe kërkimit

- Karakteristikat e objektivit që studiohet
- Procedurat e punës
- Mënyrat e marrjes së të dhënave dhe burimeve të tyre
- Metodat e përdorura për vlerësimin dhe interpretimin e rezultateve
- Metodatat statistikore

#### • Rezultatet e punës

- Rezultatet e punës dhe diskutimi i tyre janë pjesët më të rëndësishme të tezës. Rezultatet (qëndrimet e vet autorit ose zgjidhjet e autorit në lidhje me çështjen) e siguruar nga autori duhet të vendosen logjikisht dhe përshkrimi i tyre duhet të shoqërohet me komente të mjaftueshme. Autori komenton mbi të gjitha të dhënat dhe informacionet në krahasim me rezultatet e autorëve të tjerë. Nëse është e përshtatshme, rezultatet e punës dhe diskutimet mund të paraqiten si një pjesë e vetme dhe së bashku duhet të përbëjnë 30 deri në 40% të tezës.

#### • Diskutimi

#### c. Përfundime

- Në përfundim është e nevojshme që shkurtimisht studenti të përmbledhi rezultatet e marra në lidhje me qëllimet e deklaruara.

#### d. Përmbledhja (është e detyrueshme në gjuhën angleze)

- Përmbledhja në gjuhën angleze duhet të përbëjë rreth 10% të tezës.

#### e. Referencat



- Përmban një listë të plotë të referencave bibliografike. Shtrirja e kësaj pjese varet nga numri i referencave të cituara në material, të cilat duhet të korrespondojnë me citimet e përdorura në tekst.
- Të dy aspektet etike dhe teknike të përdorimit të referencave janë të rëndësishme. Etika e citimit përcakton mënyrën e respektimit të standardeve etike në lidhje me idetë e autorëve të tjerë dhe rezultatet e siguruar në dokumente dhe lista të tjera të referencave. Teknika e citimit shpreh nëse, në lidhje me standardin autori lidh citimet në tekst me publikimet që janë në listën e referencave bibliografike dhe si e bën këtë.
- Të gjitha Referencat duhet të renditen në rend alfabetik sipas mënyrës së paraqitur në formatimin e referencave në Aneksin përkatës.
- Në tezë është shumë e rëndësishme që studenti të jap referencat e duhura kur përdor formulime nga literatura. Referencat njohin punën e të tjerëve dhe u japin lexuesve informacionin mbi burimet që keni përdorur dhe shmangin plagjiaturën. Plagjiatura konsiderohet përdorimi i tekstit të një personi tjetër si tuajin pa bërë referenca të sakta burimesh. Plagjiatura konsiderohet si vjedhje e punës së një personi tjetër dhe studenti vlerësohet për punën që në fakt nuk është e tij/saj. Studentët duhet të shmangin plagjiaturën duke vendosur gjithmonë një referencë të saktë burimi kur përdorin punët e individëve të tjerë
  - kjo vlen edhe për citime, riprodhime, interpretime, përkthime, figura, ilustrime etj. Kur studenti prodhon një tekst, duhet të shfaqet qartë cilat janë idetë e veta dhe cilat pasazhe janë rezultat i përpunimit të njohurive të njerëzve të tjerë. Studentët duhet të jetë i vetëdijshëm se plagjiatura është përgjegjësia e tyre!

## NË PËRFUNDIM

1. Studenti të mos presë që të filloj dhe përfundoj tezën e tij/saj në të njëjtin semestër. Studenti duhet të bëj përparim të rëndësishëm (që zakonisht do të thotë që po grumbullon të dhëna) para se të diplomohet. Mbrojtja planifikohet kur teza është përfunduar me sukses.
2. Studenti nuk duhet të presë që anëtarët e komisionit apo recesenti të redaktoj tezën e tij/saj. Studenti gjatë rishikimit të vazhduar të punimit duhet të redaktoj me kujdes dhe të kontrolloj punën e tij/saj. Redaktimi ndodh të paktën në dy nivele të ndryshme.

**Mikro-redaktimi** përfshin korrigjimin e gabimeve drejtshkrimore dhe gramatikore. Ai gjithashtu përfshin kontrollin për paragrafin e duhur dhe strukturën e fjalisë, përdorimin e vazhdueshëm të termave dhe shumëllojshmërinë në zgjedhjen e fjalëve.

**Makro-redaktimi** vlerëson strukturën e përgjithshme të tezës. Kjo do të thotë që studenti duhet të sigurohet që çdo kapitull rrjedh logjikisht nga kapitulli i mëparshëm, titujt e kërësive dhe nënkrerët janë përdorur siç duhet dhe janë të përfshira ndërprerje midis temave kryesore. Redaktimi gjithashtu përcakton nëse ndonjë pjesë e tezës duhet të harmonizohet ose zgjerohet. Në disa raste, mund të jetë e nevojshme që studenti të kërkoj ndihmën e një redaktori profesionist.

3. Studenti duhet ti lejoj kohën e duhur udhëheqësit dhe recesentit të lexojë tezën e përfunduar. Studenti nuk duhet presë që pasi të paraqesi për herë të parë tezën e përfunduar, do ta mbroj në të njëjtën ose në javën pasardhëse. Studenti duhet të dorëzoj tezën e përfunduar tek udhëheqësi dhe recesenti të paktën një muaj përpara mbrojtjes.
4. Studenti duhet të përgatitet për rishikime të materialit përpara mbrojtjes.

5. Studenti duhet të dorëzoj tek anëtarët e komisionit një kopje të lidhur të versionit përfundimtar të tezës.

## STRUKTURA E TEZËS SË DIPLOMËS

### ASPEKTE TË PËRGJITHSHME

- Punimi duhet të respektojë kërkesat e formatit. Nëse punimi nuk prezantohet sipas formatit të kërkuar, ai nuk pranohet derisa të plotësohen të gjitha kërkesat e formatit.
- Në kopertinë duhet të vendoset emri i Universitetit, fakultetit, programi i studimit., titulli i plotë i temës, emri i kandidatit, emri i udhëheqësit shkencor, viti i mbrojtjes.
- Gjatësia e punimit nuk mund të jetë më i vogël se 60 faqe.
- Kopjet e printuara të tezës duhet të jenë në një letër A4, të një cilësie të mirë (21cm x 29.7cm).
- Materiali duhet të shtypet vetëm nga njëra anë e letrës. Teksti duhet të shtypet me hapësirë 1.15 ndërmjet radhëve. Vetëm një lloj shkrimi duhet përdorur. Lloji i shkrimit duhet të jetë Times New Roman. Masa e shkronjës duhet të jetë 12; first line 0.3.
- **Margjinat** për të gjithë tekstin do të jenë:
  - Margjina e sipërme 1”
  - Margjina e poshtme 1”
  - Margjina e majtë 1.25”
  - Margjina e djathtë 1.25”
- Të gjitha **numrat e faqeve** duhet të vendosen poshtë dhe në mes të faqes.
- **Shënimet** duhen të bëhen me shkrim Times New Roman, 12, hapësira single.
- **Tabelat** të përfshihen në tekst. Tabelat duhet të vendosen në qendër të faqes, brenda margjinave të caktuara. Çdo tabelë i duhet vendosur një numër referimi që duhet të ndjekë numrin e kapitullit të cilit i përket. Fjala “Tabela”, numri i tabelës dhe legjenda duhet të vendosen në krye të tabelës. Shkrimi duhet të jetë Times New Roman, 12, bold. Nëse tabela vazhdon në faqen tjetër legjenda nuk përsëritet. Nëse një tabelë përmban citate, referencat duhet të theksohen.
- **Ilustrimet dhe diagramat**, duhet të skanohen dhe të inkorporohen në versionin elektronik të dokumentit. Fjala “Figura”, numri i diagramës që ndjek numrin e kapitullit të cilit i përket, dhe legjenda të vendosen poshtë diagramës apo figurës. Shkrimi duhet të jetë Times New Roman, 12, bold.
- **Literatura** e cituar në tekst do të jetë me mbiemër të autorit dhe të tjerë (Brayan et al, 2006).



## MODELI I TEZËS SË DIPLOMËS

- Në faqen e parë shkruhet, në pozicionin e mesit dhe me shkrim të qëndëruar (center text): **“Copyright, # I # Emri Mbiemri i studentit, # Viti”**. (shënim: Shenja # është përdorur për të treguar fillimin e një rreshti të ri).
- Në faqen e dytë në pozicionin e sipërm, shkruhet me shkrim të qëndëruar: **“Udhëheqësi i Emri Mbiemri i Studentit vërteton se ky është versioni i miratuar i tezës të mëposhtme:”** dhe më tej vazhdohet në pozicionin e 1/3 së faqes rishkruhet **Titulli i Temës** me gërma kapitale dhe shkrim 16, Times New Roman. Më poshtë, me hapësirë të trefishtë, shkruhet në të djathtë Emri i udhëheqësit shkencor dhe firma përkatëse.
- Në faqen e Tretë në pozicionin e sipërm, shkruhet me shkrim të qëndëruar rishkruhet **Titulli i Temës** me gërma kapitale dhe shkrim 16, Times New Roman. Në pozicionin e 1/3 së faqes shkruhet Përgatitur nga, Emri Mbiemri i studentit, Më poshtë, me hapësirë të trefishtë, shkruhet me shkrim të qëndëruar teksti: **“Temë diplome e paraqitur në # Fakulteti i ....., # Universiteti i Sporteve te Tiranës # Në përputhje të plotë # Me kërkesat # Për ciklin e studimit “xxxx”**. Faqja mbyllet me shkrimin **Universiteti i Sporteve te Tiranës. # Muaji, Viti** (shënim: Shenja # është përdorur për të treguar fillimin e një rreshti të ri)
- Në faqen e katërt shkruhet “Dedikim”, i cili është fakultativ
- Në faqen e pestë shkruhet “Mirënjohje/falenderim” e cila është gjithashtu fakultative.
- Në faqen e gjashtë shkruhet ky tekst:

Deklaratë mbi originalitetin

Emri Mbiemri

Deklaroj se kjo tezë përfaqëson punën time origjinale dhe nuk kam përdorur burime të tjera përveç atyre të evidentuara nëpërmjet citimeve. Të gjitha të dhënat, tabelat, figurat dhe citimet në tekst të cilat janë riprodhuar prej ndonjë burimi tjetër, duke përfshirë dhe internetin, janë pranuar në mënyrë eksplicite si të tillë.

Vendi, data



- Në faqen e shtatë jepet, **“Përmbajtja e Lëndës”** e cila duhet të jetë e detajuar; kapitujt, titujt dhe nën-titujt e çdo kapitulli dhe numri përkatës i faqeve. Në vijim jepet **“Lista e tabelave”** dhe **“Lista e figurave”** e shoqëruar me numrat përkatës të faqeve.
- Më pas vazhdohet me kapitujt e temës së diplomës:
  - “Hyrja”,
  - “Qëllimi i studimit”, “Materiali dhe Metoda”, “Rezultatet”,
  - “Diskutimet” (ose “Rezultatet dhe Diskutimet”), “Konkluzione”,
  - “Përmbledhje”, “Literatura”.
  - Për diplomat e shkruara në formën e përmbledhjes së literaturës (Review) do të përbëhen nga këto kapituj:
  - “Hyrja”,

- “Informacione themelore”, “Vështrim mbi arritjet e fundit”,
  - “Identifikimi i problematikave të një çështjeje të caktuar”,
  - “Konkluzionet për zgjidhjen e problemit”, sipas dëshirës së studentit.
  - Çdo kapitull ka çështjet dhe nënçështjet e veta.
- Lloji i shkrimit sipas niveleve:
    - 1 **Titulli kryesor**, ose Titulli i kapitullit; Times New Roman; Bold; 16, all capital; hanging 0.3; hapësira para dhe pas tij 12;
    - 1.1 **Niveli i parë**: Times New Roman; Bold; 14; Small capital, hanging 0.4; hapësira para dhe pas tij 6;
    - 1.1.1. **Niveli i dytë**: Times New Roman; Bold; 14; hanging 0.5; hapësira para dhe pas tij 6;
    - 1.1.1.1 **Niveli i tretë**: Times New Roman; Bold dhe italic; 14; hanging 0.6; hapësira para dhe pas tij 6;
  - Formatimi i Referencave (Literatura)

#### CITIMI I REVISTAVE:

Lazo P., Stafilov T., Qarri F., Allajbeu Sh., Bekteshi L.: Spatial distribution and temporal trend of airborne trace metal deposition in Albania studied by moss biomonitoring. Ecological Indicators, 2019 101:1007-1017 February 2019.DOI: 10.1016/j.ecolind.2018.11.053

#### CITIMI I LIBRAVE

Lodish HF, Berk A: Molecular cell biology: WH Freeman; 2008.

#### CITIMI I KAPITUJVE TË LIBRAVE

Griffiths AJ: DNA: Structure and replication. In: Introduction to genetic analysis; WH Freeman, 2005: 920-940.

#### CITIMI I TEZAVE TË DISERTACIONEVE, MASTERAVE ETJ

Salihila J.: Karakterizimi kimik i ekstrakteve të disa bimëve mjeksore të vendit tonë me teknika kromatografike. PhD Dissertation. Universiteti i Tiranës, Tirane, Shqiperi, 2019.

#### CITIMI I PROCEEDINGS TË BOTUARA

Podgrabinska S, Braun P, Velasco P, Kloos B, Pepper MS, Jackson DG, Skobe M: Molecular characterization of lymphatic endothelial cells. Proceedings of the National Academy of Sciences of the United States of America 2002, 99(25): 16069.

#### CITIMI I MATERIALEVE TË PAPUBLIKUARA

Arat S, Rzucidlo SJ, Stice SL: Transgenic bovine nuclear embryos from adult somatic cell lines. Turk. J. Vet. Anim. Sci., In press.

Në mbrojtjen e punimit të diplomës verifikohet dija teorike dhe praktike si dhe aftësia e studentit që të mbrojë dhe argumentojë përfundimet vetjake në lidhje me materialin të cilën e ka përpunuar në punim.

### **PROCEDURA E MBROJTJES SË PUNIMIT TË DIPLOMËS**

- Kryetari i Komisionit e hap procedurën e mbrojtjes; Studenti prezanton problematikën themelore, metodat që ka përdorur dhe rezultatet të cilat i ka arritur në punim.





- Prezantimi realizohet duke e paraqitur punimin e diplomës në Power Point me një numër jo më shumë se 40 slidesh dhe zgjatë rreth 20- 35 minuta. Anëtarët e Komisionit i bëjnë pyetje studentit. Pas realizimit të pyetjeve, student ka të drejtë të mendojë deri në 5 minuta, dhe pas kësaj kohe duhet t'i përgjigjet pyetjeve. Pasi i përgjigjet pyetjeve të realizuara,
- Komisioni vlerëson cilësinë e punimit të diplomës, paraqitjen në formatin Power Point të temës, mënyrën e prezantimit, përgjigjet e studentit në pyetjet e realizuara dhe në bazë të kësaj përcakton notën përfundimtare të punimit të diplomës.
- Vlerësimi me notë i studentit.

